

LA SCOMPARSA DELLO SCRITTORE ISMAIL KADARE: UN GRANDE VUOTO NELLA LETTERATURA MONDIALE, NEL MONDO ALBANESE E NELLA MEMORIA DEGLI ITALO-ALBANESI



NDARJA NGA JETA E SHKRIMTARIT ISMAIL KADARE: NJË ZBRAZËTI E MADHE NË LETËRSINË BOTËRORE, NË BOTËN SHQIPTARE DHE NË KUJTESËN E ARBËRESHËVE

La scomparsa di Ismail Kadare lascia un grande vuoto nella letteratura mondiale contemporanea, nella vita culturale e sociale degli albanesi e nella memoria degli arbëreshë. Il grande scrittore, originario della città di Argirocastro (Albania del sud), dov'era nato 88 anni fa, ha riservato una costante attenzione alla civiltà letteraria sviluppata dalla comunità albanese insediata in Italia sul finire del secolo XV, non nascondendo di considerarla una testimonianza dell'autentica identità degli albanesi. Più volte e in occasioni diverse – segnaliamo, in particolare, tra quelle significativamente più vicine al mondo arbëresh, la cerimonia a Palazzo Steri per il conferimento della laurea *honoris causa* da parte dell'Università di Palermo nel 2009 e quella dell'assegnazione del premio Mediterraneo da parte della Fondazione CARICAL al teatro Rendano di Cosenza nel 2016 - Kadare

FONDAZIONE UNIVERSITARIA
FRANCESCO SOLANO
c/o Laboratorio di Albanologia_DICES

Università della Calabria
Via P. Bucci, Cubo 20A
87036 Rende (CS) - ITALIA

TEL. (+39) 0984.494110

EMAIL:
fondazioneuniversitariasolano@gmail.com

SITI WEB:
www.fondazioneuniversitariasolano.it

www.albanologia.unical.it



esprese la sua ammirazione per la letteratura degli arbëreshë e, in particolare, di Girolamo De Rada, che ammise di considerare il padre della letteratura moderna albanese.

A dare concretezza a questa sua convinzione sono i molti suoi romanzi (*I tamburi della pioggia, Il ponte a tre archi, Chi ha riportato Doruntina, ecc.*) nei quali il riferimento alla storia, alla cultura e alle tradizioni antropologiche albanesi è la cifra narrativa caratterizzante. Affascinato al pari di altri grandi estimatori albanesi e italiani della cultura arbëreshe, Kadare non ha esitato a condividere le battaglie ideali e culturali che gli arbëreshë hanno combattuto in nome dei diritti spettanti a una minoranza linguistica di storico insediamento. Memorabile fu il suo discorso tenuto nel 2003 nella Badia di Grottaferrata (cf. foto) in occasione del centenario della scomparsa di Girolamo De Rada. Le parole di Kadare ebbero un grande effetto sui presenti che gremivano l'austera aula e che ebbero modo di ascoltare dalla viva voce di una grande interprete della letteratura contemporanea quanto geniale, innovativo e talentuoso fosse stato l'estro artistico dell'intellettuale e scrittore arbëresh di Macchia Albanese.

Il ricordo di quell'evento nel corso dell'ultimo ventennio è venuto rafforzandosi anche grazie ai contatti, numerosi e sempre più calorosi, intrattenuti sia con Kadare e la moglie Helena, sia con le istituzioni scientifiche, accademiche e istituzionali albanesi in tutte le occasioni solenni dedicate all'opera e alla figura del grande scrittore albanese. Nel nome di queste relazioni la Fondazione Universitaria "Francesco Solano" dedicherà le proprie energie affinché l'eredità letteraria di Ismail Kadare, specie quella che riservata al mondo arbëresh, trovi un'adeguata valorizzazione e una opportuna forma di trasmissione alle generazioni future.

La Fondazione Universitaria "Francesco Solano" esprime a nome dei suoi organi di gestione, dei propri collaboratori e amici le più sentite e affettuose condoglianze alla famiglia Kadare, alla moglie Helena, alle figlie Gresa e Besiana, all'Accademia delle scienze, all'editore Bujar Hudhri e ai numerosi estimatori dell'opera del grande scrittore albanese.

prof. Francesco Altimari

Presidente della Fondazione Universitaria "Francesco Solano"

Campus di Arcavacata di Rende, 2-7-2024

FONDAZIONE UNIVERSITARIA
FRANCESCO SOLANO
c/o Laboratorio di Albanologia_DICES

Università della Calabria
Via P. Bucci, Cubo 20A
87036 Rende (CS) - ITALIA

TEL. (+39) 0984.494110

EMAIL:
fondazioneuniversitariasolano@gmail.com

SITI WEB:
www.fondazioneuniversitariasolano.it

www.albanologia.unical.it



Vdekja e Ismail Kadaresë lë një zbrazëti të madhe në letërsinë botërore bashkëkohore, në jetën kulturore dhe shoqërore të shqiptarëve dhe në kujtesën e arbëreshëve. Shkrimtari i madh me prejardhje nga qyteti i Gjirokastrës ku kishte lindur 88 vjet më parë, i ka kushtuar një vëmendje të vazhdueshme kulturës letrare të zhvilluar nga komuniteti arbëresh i vendosur në Itali aty nga fundi i shek. XV, duke e konsideruar atë një dëshmi të identitetit autentik të shqiptarëve. Në shumë raste, – veçojmë këtu ato më pranë botës arbëreshe, si ceremoninë e organizuar në Palazzo Steri për dhënien e titullit *Laurea Honoris Causa* nga ana e Universitetit të Palermos në vitin 2009 dhe atë të akordimit të çmimit *Mediterraneo* nga ana e Fondacionit CARICAL, organizuar në teatrin Rendano të Kozencës në vitin 2016 - Kadare shprehu admirim për letërsinë e arbëreshëve dhe sidomos për Jeronim De Radën, të cilin tha se e konsideronte Atin e letërsisë moderne shqiptare.

Këtë bindje të tij e konkretizojnë romanet e shumta (*Kështjella, Ura me tri harqe, Kush e solli Doruntinën* etj.) ku referimi ndaj historisë, kulturës dhe traditave antropologjike arbëreshe është një element narrativ karakterizues. I magjepsur sikurse intelektualë të tjerë të mëdhenj shqiptarë e italianë nga kultura arbëreshe, Kadare nuk ngurroi t'i bënte të vetat betejat ideale dhe kulturore që arbëreshët kanë ndërmarrë në emër të të drejtave që u takojnë atyre si minorancë linguistike historike të Italisë. I paharrueshëm mbetet fjalimi që mbajti në vitin 2003 në Badia di Grottaferrata (shih foton) me rastin e njëqindvjetorit të vdekjes së Jeronim De Radës. Fjalët e Kadaresë lanë mbresa të thella te të pranishmit që mbushnin sallën, të cilët patën rast të dëgjonin nga vetë goja e një interpretuesi të madh të letërsisë bashkëkohore sa gjeniale, risore dhe e talentuar ishte vepra poetike e intelektualit dhe shkrimtarit arbëresh nga Maqi.

Kujtimi i asaj ngjarjeje gjatë këtyre njëzet viteve të fundit është forcuar edhe falë kontakteve të shumta dhe dashamirëse qoftë me Kadarenë, qoftë me të shoqen Helena, qoftë me institucionet shkencore dhe akademike shqiptare në të gjitha rastet solemne kushtuar veprës dhe figurës së shkrimtarit të madh shqiptar. Në emër të këtyre marrëdhënieve Fondacioni Universitar “Francesco Solano” angazhohet me të gjitha energjitë në mënyrë që trashëgimia letrare e Kadaresë, sidomos ajo që i kushtohet botës arbëreshe, të vlerësohet dhe t’u përçohet brezave të ardhshëm.

Fondacioni Universitar “Francesco Solano” në emër të strukturave të veta, të bashkëpunëtorëve dhe miqve u shpreh ngushëllimet më të ndiera familjes Kadare, së shoqes Helena, vajzave Gresa e Besiana, Akademisë së Shkencave, botuesit Bujar Hudhri dhe adhuruesve të shumtë të veprës së shkrimtarit të madh shqiptar.

prof. Francesco Altimari

President i Fondacionit Universitar “Francesco Solano”

Campus di Arcavacata, 2-7-2024

FONDAZIONE UNIVERSITARIA
FRANCESCO SOLANO
c/o Laboratorio di Albanologia_DICES

Università della Calabria
Via P. Bucci, Cubo 20A
87036 Rende (CS) - ITALIA

TEL. (+39) 0984.494110

EMAIL:
fondazioneuniversitariasolano@gmail.com

SITI WEB:
www.fondazioneuniversitariasolano.it

www.albanologia.unical.it



Manastiri i Grottaferratës (Roma), 29-11-2003. Në foton (majtas): Ambasadorja e Maqedonisë Mirie Rushani, prof. Matteo Mandalà, shkrimtari Ismail Kadare me të shoqen Helena, dr. Virgilio Avato, Arkimandrita p.Emiliano Fabbriatore, dr. Gaetano Bonifati, on.Mario Brunetti, prof. Francesco Altimari, av.Giovanni Macri, prof.Gisele Vanhese, prof. Maria Mondella



Badia di Grottaferrata (Roma), 29-11-2003. Nella foto (da sinistra): l'Ambasciatrice della Macedonia, Mirie Rushani, il prof. Matteo Mandalà, lo scrittore Ismail Kadare con la moglie Helena, il dr. Virgilio Avato, l'Archimandrita p.Emiliano Fabbriatore, il dr. Gaetano Bonifati, l'on.Mario Brunetti, il prof. Francesco Altimari, l'avv. Giovanni Macri, la prof.Gisele Vanhese, la prof. Maria Mondella (foto di Francesco Paolo Lavriani).

FONDAZIONE UNIVERSITARIA
FRANCESCO SOLANO
c/o Laboratorio di Albanologia_DICES

Università della Calabria
Via P. Bucci, Cubo 20A
87036 Rende (CS) - ITALIA

TEL. (+39) 0984.494110

EMAIL:
fondazioneuniversitariasolano@gmail.com

SITI WEB:
www.fondazioneuniversitariasolano.it

www.albanologia.unical.it



Messaggio dello scrittore Ismail Kadare inviato alla Cattedra di Albanologia dell'Università della Calabria, coordinatrice delle iniziative promosse dal Comitato per le celebrazioni del 1°Centenario della morte di Girolamo de Rada

Të dashur zonja dhe zotërinj bashkëkombas,
në pamundësi për të marrë pjesë në kremtimet për Poetin e madh e aq të dashur, më lejoni t'jua shpreh nga larg gjithë respektin dhe admirimin tim për Birin e madh të Arbëreshëve e të gjithë Shqiptarëve, Jeronim De Radën.

Jeronim De Rada nuk është vetëm Poet i madh e i papërsëritshëm shqiptar dhe evropian. Ai është një nga krijuesit e Atdheut të humbur , një nga ata që në mes te errësirës, e mbajti te ndezur fenerin e poezisë e të kulturës shqiptare, atëherë kur Shqipëria e zhytur në terr kishte aq shumë nevojë për të. E bashkë me atë dritëz, Jeronim De Rada mbajti të gjallë ëndrrën shqiptare të lirisë dhe ëndrrën e rikthimit të Shqipërisë në kontinentin nënë, në Evropë.

Ky kolos i vjershërimit dhe i dashurisë bën pjesë ndër ata misionarë që i kthyen Atdheut letrat e humbura të fisnikërisë. Ndaj emri i tij, ashtu si vepra e tij, e ka te siguruar pavdekësinë në jetë të jetëve.

Paris, 7 tetor 2003

Signore e Signori, cari connazionali,

nell'impossibilità di prendere parte di persona ai festeggiamenti per il tanto amato e grande Poeta, consentitemi di esprimervi da lontano tutto il rispetto e la mia ammirazione per il grande figlio degli Arbëreshë e degli Albanesi, Girolamo De Rada.

Girolamo De Rada non è solo un Poeta grande e irripetibile, albanese ed europeo. Egli è uno dei creatori della Patria perduta, uno di coloro che in mezzo all'oscurità ha tenuta accesa la lampada della poesia e della cultura albanese, allorquando l'Albania, immersa nelle tenebre, aveva tanto bisogno di lui. E assieme a quella fiammella, Girolamo De Rada ha tenuto vivo il sogno albanese per la libertà e il sogno del ritorno dell'Albania nel continente materno, in Europa.

Questo colosso della versificazione e dell'amore fa parte di quei missionari che hanno restituito alla Patria le perdute carte della nobiltà. Per questo il suo nome, così come la sua opera, saranno immortali nei secoli dei secoli".

Parigi, 7 ottobre 2003

FONDAZIONE UNIVERSITARIA
FRANCESCO SOLANO
c/o Laboratorio di Albanologia_DICES

Università della Calabria
Via P. Bucci, Cubo 20A
87036 Rende (CS) - ITALIA

TEL. (+39) 0984.494110

EMAIL:
fondazioneuniversitariasolano@gmail.com

SITI WEB:
www.fondazioneuniversitariasolano.it

www.albanologia.unical.it

